

# TRUSTORJA

## KRYETITUJT E KËTIJ NUMRI

- \* Investimet: €22 mln në TM2 (faqe 2)
- \* Investimet edhe përmes Nordea (faqe 3)
- \* eTrusti vazhdon rritjen (faqe 4)
- \* 1.3% e mjeteve të pabarazuara (faqe 4)

## FAKTET KRYESORE

**Më 30 qershor 2014**

Çmimi i aksionit	€1.2493
Mjete nën menaxhim	€996,397,044.26
Pensione të shpaguara në tremujor	€4.2 mln
Llogari të kontribuuesve	460,971
Aksione të emetuara	797,580,301.19

## INVESTIMET


### Çmimi i aksionit:

Prill	0.60%
Maj	1.12%
Qershor	0.40%
Gjithsej performanca neto	2.14%

### Kthimi bruto:


Prill	€4.31 mln
Maj	€11.25 mln
Qershor	€6.35 mln
Gjithsej kthimi bruto	€21.92 mln

## PERFORMANCA KUMULATIVE E FKPK-SË NGA THEMELIMI



Periudha	1 muaj	3 muaj	Ky vit	1 vit	5 vjet	Nga themelimi
Rezultati	1.12%	2.14%	2.48%	5.49%	41.19%	24.18%

## PLASMANI I MJETEVE NË FUND TË TREMUJORIT



## PERFORMANCA E FONDEVE INVESTUESE DHE LV KOSOVË NË TREMUJOR

1. VANGUARD	▲ +4.45%	4. AXA GILB	▲ +3.02%	7. LV - KOSOVË	▲ +0.38%
2. SCHRODERS	▲ +0.56%	5. BNY MELLON	▲ +2.43%	8. Nordea GSEF	▲ 0.00%
3. ECM-DEC	▲ +2.23%	6. ALCEDA	▲ +3.79%	9. Nordea SRF	▲ +0.30%

BOTUES: Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës - Botuar: korrik 2014

Autor: Jeton Demi

Kontakt: Rr. "Agim Ramadani" Nr. 10, 10000 Prishtinë - 038-244-341 - info@trusti.org - www.trusti.org

## €22 MLN NGA INVESTIMET NË TM2

Kthimi bruto nga investimet e FKPK-së për tremujorin e dytë (TM2) të 2014-s ishte rreth €22 mln. Ky, bashkë me kthimin nga investimet në tremujorin e parë, bën gjysma e parë e vitit mbyllet me kthim bruto nga investimet prej €32 mln. Çmimi i aksionit për TM2 arriti në €1.2493, i rritur me 2.14% nga TM1, kur ishte €1.2231.

Mjetet nën menaxhim të FKPK-së u rritën për €48 mln gjatë TM2 dhe kapën shifrën e €996 mln (TM1: €948 mln), që është edhe rritje rekorde në një tremujor të vetëm. Rritja e mjeteve nën menaxhim u ndikua jo pak nga kthimi bruto nga investimet (€22 mln), por edhe nga kontributet e reja (€32 mln).

Në anën tjetër FKPK shpagoi pensione prej €4.2 mln, ndali për tarifën menaxhuese €1.3 mln dhe refondoï €0.52 mln, duke iu zbritur kështu mjeteve nën menaxhim rreth €6 mln .

### Faktorët me ndikim

Tremujori i dytë ishte kryesisht stabil për tregjet financiare globale, dhe shqetësimet nga krizat politike në Ukrainë dhe Irak nuk patën për momentin efekt negativ mbi to. Vazhdimi i politikave lehtësuese monetare në BE dhe SHBA dha efekt në zvogëlimin e lëkundjeve në tregje, por në anën tjetër ndikoi që të tkurret më tej norma e kthimit të investimeve në bonot shtetërore. Megjithatë, përmirësimi i tregut të punës në këto dy pjesë të globit, SHBA dhe BE, gjithsesi shtoi apetitin e investitorëve për më shumë risk, duke shtuar kështu investimet në tregun e aksioneve. Tregjet u mjaftuan edhe me faktin se nga vendet aziatike nuk u prodhuan ndonjë lajm negativ, ndërkohë që tregjet në zhvillim dhanë shenja të rikuperimit, edhe pse jo nivele të kënaqshme. Si rezultat bursat kryesore vazhduan gjatë TM2 të vendosin rekorde të reja të rritjes së indekseve. Lëvizjet jo të forta në tregjet financiare u reflektuan edhe në performancën mujore të investimeve të FKPK-së, duke bërë që të tre muajt të

# 2.14%

kthimi nga investimet në TM2

rezultonin me kthim pozitiv për investimet: prilli (+0.60%), maji (+1.12%) dhe qershori (0.40%).

### Performanca e fondeve investuese

Të gjitha fondet investuese përmes të cilave FKPK-ja i ka plasuar investimet në tregjet financiare ishin me performancë pozitive, përveç fondit të Nordea-s 1-GSEF, në të cilin FKPK-ja investoi në javën e fundit të këtij tremujori dhe performanca ishte 0.0%. Dominimi i tregut të aksioneve u reflektua më së shumti në fondin investues të Vanguars GSIF (+4.45%), që njëherësh ishte edhe performanca më e mirë e këtij tremujori, një fond investues *puro* në aksione. Performancë gati po kaq të mirë kishte edhe fondi me kthim absolut i Alceda-s (+3.79%) i dominuar nga bonot, dhe ai i bonove globale të lidhura me inflacionin i AXA GILB (+3.02%), i ndikuar nga rritja e inflacionit global. Aspak keq ishin edhe fondi investues i kthimit absolut i BNY Mellon (+2.43%), i ndikuar gjithashtu nga aksione, dhe fondi i kthimit fiks i ECM-DEC (+2.23%) i dominuar fort nga bonot e korporatave evropiane. Ndërsa, performanca jo e mirë e tregut të bonove shtetërore u reflektua në fondin investues të Schrodërs me vetëm +0.56% kthim nga investimet. Përveç këtyre fondeve investuese në dhjetëditëshin e fundit të TM2 u shtua edhe investimi në fondin e multi-aseteve të Nordea 1-SRF performanca investuese e të cilit ishte 0.30%. Për shkak të kohës së shkurtër të operimit kjo performancë nuk mund të analizohet më tej.

Investimi në LVK është me kthim fiks, me normë të paracaktuar, dhe interesi i llogaritur për TM2 ishte 0.38%.

**Tabela 1:** Performanca investuese në TM2 2014 dhe plasmanet investuese në fund të tremujorit

Menaxhuesi/ Entiteti/Emetuesi	Klasa e investimeve	Plasmanet (në euro)	Kthimi bruto (në euro)
Vanguard GSIF	Aksione	330,382,994.61	14,283,420.15
BNY Mellon RRF	Kthim absolut	138,674,835.57	3,290,589.32
AXA GILB	Bono globale të lidhura me inflacionin	60,872,593.69	1,842,169.57
Alceda ACRP7	Kthim absolut	28,817,320.37	1,052,442.09
ECM-DEC	Tregu i kredive	24,332,182.3	559,752.33
Schrodërs ISBF	Bono	98,699,555.02	549,573.43
Thesari i Kosovës	Bono thesari	63,812,940.53	207,390.84
Nordea 1-SRF*	Multi-asete	40,130,123.62	130,123.62
Nordea 1-GSEF*	Aksione	30,000,000.00	0.00
	<b>Gjithsej</b>	<b>815,722,545.71</b>	<b>21,915,461.35</b>

\*Investimi në këto dy fonde investuese është realizuar në javën e fundit të tremujorit andaj performanca e tyre nuk është për gjithë tremujorin e dytë.

## NORDEA I SHTOHET LISTËS SË FONDEVE INVESTUESE

Bordi Drejtues ka vendosur që listës së menaxhuesve të fondeve të hapura investuese të FKPK-së, përmes të cilave investohen mjetet pensionale, t'i shtohen edhe dy fondet e Nordea-s, duke i investuar kështu: €30 mln në 1-Global Stable Equity Fund që tregton me aksione; dhe €40 mln me Nordea 1-Stable Return Fund që tregton me multi-asete. Informacione të detajuara për këto dy fonde mund të gjenden në uebfaqen e FKPK-së ([www.trusti.org](http://www.trusti.org)) tek pjesa e investimeve për fondet e hapura investuese.

Këto investime erdhën pas ndryshimit të strategjisë investuese për mjetet pensionale nga Bordi Drejtues i FKPK-së në fund të vitit të kaluar, dhe pas përzgjedhjes së fondeve investuese me konkurs ndërkombëtar në gjysmëvitin e parë të këtij viti. Synimi përfundimtar është që të kalohet nga stadi i diversifikimit të riskut në stadin e menaxhimit të riskut, duke mundësuar kështu që investimet e FKPK-së të jenë më të mbrojtura gjatë ciklit rënës të tregjeve financiare. Ndërkohë, gjatë tremujorit të tretë pritet finalizimi i marrëveshjeve edhe me menaxhuesit e fondeve të tjera investuese të përzgjedhura provizionalisht nga konkursi i sipërpërmendur. Totali i investimeve në fondet e reja

# €70 mln

Mjetet e investuara përmes dy fondeve të reja investuese

investuese pritet ta kalojë shifrën e €200 mln.

Për dijeni, Nordea është grupi më i madh financiar në Evropën Veriore dhe e ka selinë në Stokholm të Suedisë. Nordea ka filluar se operuari më 1830, dhe në fund të vitit 2013 kishte €630 miliardë mjete në total dhe kishte afro 30 mijë të punësuar. Prej 1992-s Nordea ka hyrë në tregun e menaxhimit të mjeteve dhe prej 2004-s ka ofruar menaxhimin e produkteve me kthim absolut. Nordea ka një emër të njohur ndërkombëtar në menaxhimin e mjeteve duke marrë një sërë çmimesh ndërkombëtare. Përveç se në shtetet nordike Nordea është prezente edhe në SHBA, Evropë dhe Azi.

Ju kujtojmë se FKPK-ja investon sipas Manualit të ri të Investimeve, të cilin mund ta lexoni duke kopjuar adresën elektronike në vijim:

[http://trusti.org/Dokumentet/Shqip/SIP\\_20131213\\_shq.pdf](http://trusti.org/Dokumentet/Shqip/SIP_20131213_shq.pdf)

## INVESTIMET NË KOSOVË €64 MLN NË FUND TË TM2

FKPK-ja në fund të gjysmës së parë të këtij viti i kishte rreth €64 mln të investuara në instrumentet e borxhit të emetuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Rreth €28 mln euro janë investuar rishtazi në TM2, ndërsa pjesa tjetër, €36 mln, ishin investime të mëhershme. Gjatë këtij tremujori kanë maturuar edhe €26 mln investime. Nga shuma prej €64 mln, €58 mln ishin Letra me Vlerë me afat maturimi nën 1-vit, dhe rreth €6 mln ishin në fletobligacione me afat maturimi 2-vjeçar. Kjo njëkohësisht ishte edhe hera e parë që FKPK-ja investoi në instrumente 2-vjeçare të borxhit të Kosovës, duke sinjalizuar kështu rritjen e kredibilitetit financiar të vendit.

Në krahasim me tremujorin paraprak (TM1: €62.8 mln) vlera e investimeve nuk ka ndryshuar shumë, kjo edhe kryesisht për faktin se FKPK-ja nuk ka fituar në ankandet e zhvilluara. Aktualisht FKPK-ja ka investuar në 6-ankande të ndryshme të emetimit të letrave me vlerë dhe fletobligacioneve të Kosovës, me vlerën maksimale €17.8 mln dhe atë minimale €3.4 mln. Në anën tjetër investimet në tregjet financiare ishin në total prej €70 mln, përmes dy fondeve të Nordea-s, dhe rabatet e Vanguard prej 96 mijë euro të cilat janë ri-investuar.

## MJETET NËN MENAXHIM I AFROHEN €1 MILIARDËSHIT

Në fund të tremujorit të dytë mjetet nën menaxhim të FKPK-së iu afruan 1 miliard eurove, €996 mln më saktë. Për dijeni, nga këto afro 1 miliard euro, rreth €853 mln (85.3%) janë kontribute të akumuluar nga kontributdhënësit kosovarë, dhe pjesa tjetër, rreth €147 mln (14.7%), është vlera neto që i është shtuar mjeteve nga investimi në tregjet financiare

globale. Rritja e mjeteve nën menaxhim gjithsesi se i hapë Bordit Drejtues të FKPK-së më shumë mundësi investuese në produkte të reja të botës financiare.

## €4.2 MLN PENSIONE TË SHPAGUARA

Gjatë TM2 €4.2 mln ishte vlera që i është kaluar në llogaritë bankare 1,345 përfituesve të pensionit (TM1: €3.8 mln; 1,086 përfituesve). Analizuar sipas arsyes së shpimit rezultojnë se: 83% e kësaj vlere iu shpagoi 1,043 përfituesve të pensionit të moshës (TM1: 79%; 803 të pensionuarve), 15% të saj e tërhoqën trashëgimtarët e 254 kontribuuesve të vdekur (TM1: 19%, 242 trashëgimtarë), dhe 2% shkoi tek 48 përfituesit e pensionit të invaliditetit (TM1: 2%; 41 përfitues). Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më

# 50%

**më shumë pensione të shpaguara sesa në TM2 2013**

parë, vlera e pensionit të shpague është rritur për 50%, nga €2.8 mln në €4.2 mln; ndërsa numri i përfituesve është ulur për 19%, nga 1,651 në 1,345 përfitues. Ndërsa bilanci mesatar i llogarive në fund TM2 ishte €2,871 për llogaritë aktive dhe €1,920 për të gjitha llogaritë ekzistuese.

## FKPK-JA U SHËRBEU 12,765 KONTRIBUESVE NË TM2

Gjatë tremujorit të dytë FKPK-ja iu ka ofruar shërbime 12,765 kontribuuesve. Shumica e këtyre shërbimeve u dominuan nga shtypja e pasqyrave (55%), autorizimeve të llogarive të reja në eTrusti (19%), aplikimi për pensionim (10%) dhe nga ndryshimi i adresave (7%). Të gjithë shërbimet e tjera përbënin 9% të numrit dhe përfshinin: kontrollimin e llogarisë, ndryshimin e adresës së banimit, shtypjen e llogarive të punëdhënësve dhe ndryshimin e të dhënave të kontaktit. Numri i shërbimeve të ofruara nga FKPK-ja ka një rënie të lehtë gjatë TM2, krahasuar me TM1, por kjo ndodhë

për arsye të sezonalitetit të shërbimeve por edhe të rritjes së numrit të shërbimeve që kontribuuesit po vazhdojnë t'i kryejnë vetë nga eTrusti. Ishin 2,399 shërbime që kontribuuesit i kanë kryer në portalin e eTrusti-t, që është një shifër rekorde e vetëshërbimit nga ata. Përveç nga zyra e FKPK-së kontribuuesit jo pak janë shërbyer edhe nga zyrtarët pensionalë të ATK-së në rajone, duke iu ofruar kontribuuesve rreth 7 mijë shërbime, të cilat në 92% të rasteve kanë qenë kërkesa për shtypjen e pasqyrave të llogarisë.

## VETËM 1.3% E KONTRIBUTEVE TË ARKËTUARA TË PABARAZUARA

Në fund të tremujorit të dytë përqindja e mjeteve të pabarazuara ra në 1.3% e totalit të mjeteve të arkëtuara, duke qenë kështu një minimum historik. Ky nivel është ulur nga 1.5% sa ishte gjashtë muaj më parë, ndërsa në vlerë përkatesisht ka rënë nga €12.8 mln në €11.9 mln. Mjaft inkurajues është lajmi se për kontributet e arkëtuara në vitin 2014, niveli i mjeteve të pabarazuara është vetëm sa 0.36% e tyre. Pra nga rreth €62 mln kontribute të arkëtuara, vetëm

për 229 mijë prej tyre FKPK-ja nuk ka ende informacion se kujt i takojnë. Për më shumë, pjesa dërrmuese e këtyre mjeteve të pabarazuara janë për mungesë të raporteve për kontributet e paguara, por janë edhe gjoba e interesa të paguara gabimisht në llogarinë e FKPK-së. Përkundër kësaj FKPK-ja vazhdon ta ketë në listën e prioriteteve që të vazhdojë të angazhohet në gjetjen e informacioneve për uljen maksimale të mjeteve të pabarazuara.

## VAZHDON RITJA E NUMRIT TË PËRDORUESVE TË eTRUSTI

Numri i përdoruesve të shërbimit elektronik eTrusti arriti në shifrën e 33,754 llogarive, e shtuar për 10% në krahasim me TM1 kur numri i përdoruesve ishte 30,712 sosh. Ritmi i rritjes së përdoruesve ka rënë në krahasim me rritjen në TM1, kur ishte 29%, por që edhe ky nivel i rritjes mund të vlerësohet për momentin i kënaqshëm, pasi, mesatarisht, për çdo muaj të TM2 janë hapur nga 1

mijë llogari të reja. Krahasuar me fundin e 2013-s numri i përdoruesve të eTrustit është shtuar për gati 10 mijë llogari të reja ose 41%. Vlen të përmendet edhe fakti se përdoruesit e eTrusti-t janë gjithnjë e më aktiv, dhe vetëm gjatë TM2 janë gati 2,400 ndryshime të: adresave të banimit, adresave të e-mailit, numrave të telefonit e të tjera, të kryera nga vet përdoruesit.